



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI  
VENDIM

Nr. 61, Datë 19.04.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY 24”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.04.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGY 24” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ENERGY 24” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ENERGY 24” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 273 Prot., datë 04.04.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “ENERGY 24” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjise elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “d” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca), neni 9, pika 3, **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjise elektrike, neni 9, pika 4.8, **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti).

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ENERGY 24” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**